



Pranuar / Dostignut Primit / Priznato Received / Dostignut	31.01.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojç e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKIMSHICK	1108/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1222/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1222/2022, të datës 19.12.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër Përgjigjes Nr.4512 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të datës 16.12.2022, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.01.2022, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1222/2022 e datës 19.12.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Përgjigja Nr.4512 e datës 16.12.2022, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe rivendosje tek Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën I të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e cila sipas shkresave të lëndës është kandidatë në procedurën e rekrutimit "Zyrtar i Lartë për Pesticide" të shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural, me datë 13.10.2022 nëpërmjet adresës zyrtare elektronike [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 19.12.2022 dhe është protokolluar me numër 8202/2022, Përgjigjes Nr.4512 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të datës 16.12.2022.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Komisioni i Vlerësimit ka zbatuar gabimisht dispozitat a aplikuara ligjore me rastin e vlerësimit të kandidatës fituese ndërsa në përgjigjen e dhënë nuk ka dhanë asnjë sqarim lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e datës 07.12.2023, ngase me rastin e përfundimit të procedurës nuk janë shpallur rezultatet përfundimtare përveç njoftimit për kandidatin fitues si dhe kandidati fitues nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit ndërlidhur me kualifikimin profesional.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa me datë 12.01.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 19.12.2022 parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; E-mailin e datës 19.12.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Përgjigjen Nr.4512 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë të datës 19.12.2022; Njoftimin e kandidatit fitues i datës 02.12.2012; Konkursin e shpallur të datës 13.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.12.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 12.01.2023; Vendimin e datës 18.11.2022 për themelimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë; Listën e përgjithshme të aplikantëve; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve e datës 01.12.2022; Ankesën e ankueses të datës 07.12.2022 të parashtruar në Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë; E-mailin e datës 22.11.2022 dërguar nga F.M për ankuese; Njoftimin e datës 10.11.2022; E-mailin e datës 29.11.2022 dërguar nga F.M për ankuese; Njoftimin e datës 18.11.2022; E-mailin e datës 10.11.2022 dërguar nga F.M për ankuese; E-mailin e datës 27.12.2022 dërguar nga F.M për Këshill; Aplikacionin e datës 04.11.2022 të kandidatit B.Q me dosjen e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 29.10.2022 të kandidatit R.M me dosjen e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 28.10.2022 të ankueses me dosjen e bashkangjitur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ekzistojnë rrethana dhe bazë e mjaftueshme ligjore, që ankesa e ankueses të kthehet në *ri-shqyrtimi dhe rivendosje te organi i njëjtë*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 13.10.2022 ka shpallur konkursi për pozitën "Zyrtar i Lartë për Pesticide" të tipit lëvizje brenda kategorisë me numër të Referencës: RN00010121, ndërsa kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

•**Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë/a të studimeve Universitare-në Bujqësi, Kini apo relevante me të paktën 240, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to (në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor.*

•**Përvoja e punës:** *Se paku dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën e kërkuar për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja sipas aplikacionit të datës 28.10.2022 konstatohet fakti se ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër të Referencës: RN00010121, dhe e njëjta i është nënshtruar intervistës me gojë, ndërsa sipas Njoftimit të datës 02.12.2022 nuk rezulton se është kandidati me më së shumti pikë. Tutje, ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e saj, me datë 07.12.2022 parashtron ankesë tek Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me pretendime ankimore se me rastin e përfundimit të procedurës nuk janë shpallur rezultatet përfundimtare përveç njoftimit për kandidatin fitues si dhe kandidati fitues nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit ndërlidhur me kualifikimin profesional, ndërsa Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë nxjerrë përgjigjen e datës 16.12.2022 të cilën ia përcjellë ankueses.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar përmbajtjen e Përgjigjes Nr.4512 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë të datës 16.12.2022, dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni në fjalë vetëm ka përshkruar në mënyrë kronologjike procedurën e rekrutimit për pozitën në fjalë, duke mos shqyrtuar asnjërin nga pretendimet e ngritura ankimore të ankueses përmes ankesës së datës 07.12.2022, siç përcaktohet me paragrafi 1 të nenit 134 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *“Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë”*, sikurse përgjigja e dhënë nuk i plotëson asnjërin nga elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuara me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga rrjedh si e tillë Përgjigja e datës 16.12.2022 e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë është e kundërligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.21, 1.4 dhe 1.5 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkëlqes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*.

Tutje Kolegji i Këshillit thekson faktin sipas dispozitave të Rregullore Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës neni 50 paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar se: *“1.Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual. 2.Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”*, nga rrjedh se përcaktimi i kësaj norme është në pajtueshmëri me frymën e nenit 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e që e obligon Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë që të shqyrtojë ankesat e brendshme duke nxjerrë vendim, e jo të përshkruaj në mënyrë kronologjike procedurën e rekrutimit sikurse ka ndodhur me rastin e nxjerrjes së Përgjigjes së datës 16.12.2022, pa dhanë asnjë sqarim ligjor lidhur me pretendimet ankimore të palës ankuese.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e administruara të lëndës të ofruara nga palët në procedurë sikurse edhe konstatimet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se Përgjigja Nr.4512 e nxjerrë nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë me datës 16.12.2022, është e paligjshme dhe si e tillë është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa lënda e ankueses është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë që e ka nxjerrë përgjigjen, gjegjësisht tek Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, ndërsa me rastin e rishqyrtimit të lëndës Komisioni i Vlerësimit duhet të shqyrtoj të gjitha pretendimet ankimore të ankueses të paraqitura në ankesën e datës 07.12.2022, duke marr për bazë vërejtjet e dhëna ligjore si në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa me rastin e vendosjes së lëndës të nxjerrë akt administrativ duke e arsyetuar të njëjtin siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe në mbështetje të ligjit material.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1222/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.